

MENDIM PARALEL

Unë, Lulzim Hamitaj, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit kalimtar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Lorenc Mërkuri, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë – duke mbështetur vendimmarrjen përfundimtare për shkarkimin e tij nga detyra, por duke mos qenë dakord me një pjesë të konsiderimeve dhe qëndrimeve të mbajtura nga dy anëtarët e tjerë të trupës - në vijim po pasqyroj mendimin tim paralel/ndryshe ndaj arsytimit të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me kualifikimet e deklarimeve si të rreme dhe me konkluzionin përfundimtar mbi rivlerësimin e aftësive profesionale të këtij subjekti.

1. Nisur nga fakti që në fund të analizimit të pasurisë nr. 1, konkretisht, në pikën 77 të vendimit në fjalë, është konkluduar se: *“[...] që lidheshin me krijimin e kësaj pasurie, në vlerësimin e trupit gjykues bëjnë që të ndodhet në kushtet pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, si dhe germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 [...]”, saktësoj se në rrethanat e faktit përballë të cilave gjendemi, sipas vlerësimit tim lidhur me këtë pasuri, ka vend për aplikimin e dispozitës ligjore të parashikuar në pikën 3 të nenit 61, të lartpërmendur, por nuk konstatoj elemente të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë.*
2. Gjithashtu, nuk ndaj të njëjtin mendim për sa i takon konkluzioneve të arritura në pikat 152.1 dhe 152.2 të vendimit në fjalë, ku konkretisht shprehet se: *“[...] 152.1 Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 69.30 m², zona Turizëm-***, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë kryer deklaram të rremë sipas germës ‘ç’, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016” dhe “152.2 Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe duke konsideruar edhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...]” .*
3. Qëndrimi ndryshe edhe në këtë rast konsiston në moskonsiderimin e fakteve dhe rrethanave të analizuara dhe të përshkruara si të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rreme. Ky konkluzion arrihet duke vlerësuar të gjithë panoramën rrethanore, nëpërmjet konsiderimit dhe çmuarjes të sa vijon, në raport me dispozitat rregulluese përkatëse:
 - i. Bëhet fjalë për veprime dhe informacione që nuk burojnë drejtpërdrejt nga veprimet apo dijenitë e subjektit të rivlerësimit, *in prima persona*, por për veprime, fakte dhe rrethana të kryera apo të njohura nga persona të tretë dhe, më pas, të referuara te subjekti. Në këto kushte – pa e anashkaluar detyrimin e subjektit për të deklaruar saktë dhe për të provuar burimet financiare edhe për personat e lidhur apo të tjerë të lidhur – nuk mund të konsiderohet deklaram i rremë ai deklaram që pasqyron një fakt apo informacion sikurse i është referuar deklaramesit, thjesht për faktin se përmbajtja nuk është plotësisht e saktë;

- ii. Konstatimet, lidhur me problematikën e deklarimeve në fjalë, konsiderohen si të përthithura brenda konkluzionit të cilësimit të deklarimeve si “*të pamjaftueshme*”, i cili çmohet i duhuri dhe i prodhon efektet e veta edhe lidhur me masën e aplikueshme ndaj deklaruesit, pa qenë nevoja dhe rasti për të shkuar në kualifikimin si “*deklarim të rremë*”.
 - iii. Vlerësoj se në rastet në fjalë nuk është kristalizuar ndonjë veprim specifik i subjektit, që të kishte për qëllim, apo të prodhonte pasojën e deformimit të fakteve reale ose pasqyrimin të tyre ndryshe, për të fshehur pasuritë apo për të tentuar një gjë të tillë, nëpërmjet deklarimeve të pavërteta, për sa ka qenë në dijeni.
4. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa është konkluduar në vendimin *de quo*, çmohet se shkeljet apo mangësitë profesionale të konstatuara nuk mjaftojnë për kualifikimin e subjektit si të papërshtatshëm profesionalisht dhe aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Kjo, pasi përmbajtja dhe pesha substanciale e problematikave profesionale të konstatuara përgjatë hetimit administrativ, gërshtuar me numrin e çështjeve të kufizuara, në të cilat janë evidentuar (në raport me dosjet e shqyrtuara), në vlerësimin tim nuk mjaftojnë për t’i konsideruar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit poshtë nivelit minimal kualifikues, të parashikuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
5. Megjithatë, problematikat që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit, të evidentuara përgjatë hetimit administrativ, në pjesën që kanë mbetur pa shpjegime bindëse nga ky i fundit, çmohet se duhet që të konsiderohen dhe vlerësohen së bashku me elementet e tjera të konstatuara në lidhje me figurën dhe me etikën – për sa i përket rrethanës së përshkruar në konkluzion të pasurisë nr. 2 (pika 97 e vendimit), pasi në tërësinë e tyre krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, në këto kushte, konsiderohet i bazuar aplikimi i pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Anëtar i trupit gjykues
(me mendim paralel)
Lulzim Hamitaj